



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**VENDIM**

**NR. 7/21 , DATË 01 / 08 /2023**

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT  
“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR” PËR  
PROJEKTIN E INVESTIMIT “NDËRTIM KOMPLEKSI TURISTIK NË ZONËN  
BREGDETARE GOLEM-BERYL RESORT” ME SUBJEKTE APLIKUES  
"VORTEK" SH.P.K NUIS/NIPT K11708004O DHE "BEST DUTY FREE" SH.P.K  
NUIS/NIPT K01621002N”**

Në mbështetje të Nenit 9, nenit 13, nenit 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/c të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti i investimit parashikon ndërtimin e një kompleksi turistik, ku do të ketë një hotel me 5 yje me 250 dhoma dhe njësi akomoduese, 16 vila elitare, 32 apart-hotele, ambiente shërbimi si bare dhe restorante, SPA, mjedise sportive, Muzeu Beach Bar Bunker, si dhe një mol me kapacitet të vogël për varka me pedalin ose lopata, në ZK Nr. 3101, Fshati Golem, Bashkia Kavajë.
- Vlera e investimit për projektin e propozuar parashikohet të jetë 16,804,112 (gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e katër mijë e njëqind e dymbëdhjetë) Euro dhe numri i të punësuarve parashikohet të jetë 100 punonjës të përhershëm dhe 18 punonjës sezonal.
- Pasuritë e paluajtshme që preken nga projekti i investimit të propozuar sipas konfirmimeve kadastrale janë:

Pasuria me nr.1/535, Z.K. 3101, Qerret, e llojit “Pyll” me sipërfaqe 4420.8m<sup>2</sup> në pronësi Republika e Shqipërisë, e cila ka të shënuar në seksionin C-(të drejtat reale) referencën nr.00005210, datë13.05.2017, Kontratë Qiraje për dhënie në përdorim të fondit pyjor kombëtar datë 24.03.2007 ndërmjet Bashkisë Kavajë dhe subjektit Vortek sh.p.k. me afat deri në datë 16.09.2023 dhe ref.00006007, datë 15.04.2009, dhënë në administrim Bashkisë Kavajë sipas VKM Nr.66 datë 21.01.2009 dhe Vendimit nr.433 datë 08.06.2016.

Pasuria me nr.1/536, Z.K.3101, Qerret, e llojit “Pyll” me sipërfaqe 5751.5m<sup>2</sup> në pronësi Republika e Shqipërisë e cila ka të shënuar në seksionin C-(të drejtat reale)

referencen nr.00005210, datë 13.05.2017, Kontrate Qiraje për dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar datë 24.03.2007 ndërmjet Bashkisë Kavajë dhe subjektit Vortek sh.p.k. me afat deri në datë 16.09.2023 dhe ref.00006007 dhënë në administrim Bashkisë Kavajë sipas VKM Nr.66 datë 21.01.2009 dhe Vendimit Nr.433 datë 08.06.2016.

Pasuria me nr.1/540, Z.K. 3101, Qerret, e llojit “Pyll” me sipërfaqe 650 m2, në pronësi Shtet.

Pasuria me nr.1/541, Z.K.3101, Qerret, e llojit “Pyll” me sipërfaqe 20416.9 m2 në pronësi Shtet.

Pasuria me nr.1/416, Z.K.3101, Qerret, e llojit “Pyll” me sipërfaqe 105737.7 m2 në pronësi Republika e Shqipërisë.

- Subjektet "Vortek" sh.p.k NUIS/NIPT K11708004O dhe "Best Duty Free" sh.p.k NUIS/NIPT K01621002N kanë aplikuar edhe dy herë të tjera për të njëjtën gjurmë. Këto aplikime janë trajtuar me Vendim nr.7/6, datë 15/12/2020 të Komitetit të Investimeve Strategjike dhe Vendim nr. 1/16, datë 15/07 /2021 të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

#### **KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE VENDOSI:**

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Ndërtim kompleksi turistik në zonën bregdetare Golem”, me subjekte investues “Vortek" sh.p.k NUIS/NIPT K11708004O & "Best Duty Free" sh.p.k. NUIS/NIPT K01621002N”, Fshati Golem, ZK 3101, Bashkia Kavajë në procedurën e asistuar dhe mbështetjen që ofron ky status.
2. Projekti prek destinacione prone të kufizuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe pjesërisht tipologjia e strukturave të propozuara nuk përputhet me parashikimet e legjislacionit të turizmit.
3. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTËR**

EDI RAMA

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
BELINDA BALLUKU

**MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
DELINA IBRAHIMAJ

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
MIRELA KUMBARO

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
FRIDA KRIFCA

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT**  
ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS  
SOKOL NANO